



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228289

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05437172

C.nr.197/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri në çështjen juridike të paditësit N.M nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson av.N.A nga Vushtrria kundër të paditues K... sh.a, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.L, lidhur me kompensim dëmi, pas mbajtjes së seances së shqyrtimit kryesor e verbal të datës 08.03.2024, jashte seance, me datën 12.03.2024, e mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N.M, kundër të paditues K... sh.a, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit si rrjedhojë e djegies së deposë dhe gjësendeve të paditësit, në fatkeqësinë e datës 13.01.2017 në lartësi të përgjithshme prej 14,797 euro, me kamatë ligjore nga dita e parashtimit të padisë e gjerë në pagesen definitive si dhe shpenzimet e procedures në lartësi të përgjithshme prej 3338 euro.

II.Detyrohet paditësi N.M nga Vushtrria që në emër të shpenzimeve procedurale, të paditues të i'a paguaj shumën prej 170 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 24.04.2017, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditues, me arsyetimin se me datën 13.01.2017 me rastin e shkaktimit të zjarrit, dhe si pasojë e zjarrit është djegur dhe dëmtuar depoja e patateve që në të ka pasur rreth 70 tonë, patate dhe gjësende të tjera sic janë përshkruar në raport të vecant të policisë. Po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga vërtetimi i lëshuar nga NPZSh në Vushtrri. Shton se deponë e ka pasur me dimensione 13x8 m, se paditësi i është drejtuar të paditues për zhdëmtim por e njëjta nuk e ka njoftuar fare. Ka propozuar aprovimin e padisë dhe kërkesëpadiës në lartësi prej 9900 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedures.

Paditësi gjatë procedures ka precizuar kërkesën e tij duke kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadiës së precizuar dhe detyrimin e të paditues që në emër të dëmit të shkaktuar të ia paguaj shumën prej 14,797 euro me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë me datën 24.04.2017, e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedures në lartësi të përgjithshme prej 3338 euro.

Përfaqësuesi i paditësit av.N.A gjatë gjithë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadiës së precizuar të paditësit me arsyetimin se e paditura ka përgjegjësi objektive për dëmin e shkaktuar.

Përfaqësuesi i të paditurës V.L gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit duke shtuar se nga provat e administruara dhe dëgjimit të ekspertit të elektros B.F, vërtetohet fakti se dëmi është shkaktuar në zonen e përgjegjësisë së paditësit, dhe se e paditura në një situatë të tillë, nuk ka përgjegjësi për rastet që shkaktohen jashtë njuhësorit dhe i takojnë konsumatorit. I ka propozuar gjykates që ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta obligoj paditësin të paguaj shpenzimet procedurale të krijuar në këtë kontest për ekspertizë të elektros.

Me qëllim të vërtetimit dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike janë lexuar dhe administruar provat: dëftesë pagesen e datës 11.04.2017, raportin e veqant të lëshuar nga Stacioni Policor në Vushtrri, i datës 13.01.2017, raporti mbi deklarinimin e rastit në polici, datë 13.01.2017, vërtetimi i lëshuar nga NPZSh në Vushtrri, i datës 16.01.2017, kërkesa për kompensim dëmi drejtuar të paditues datë 03.03.2017, ekspertiza mbi shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm e kryer nga eksperti A.N e datës 01.02.2017, raportin e komisionit të të paditues të datës 09.03.2017, formularin e ankesave të konsumatorit të datës 03.03.2017, ekspertizen gjyqësore nga lëmia e ndërtimtarisë e kryer nga eksperti D.Sh të datës 13.0.2017, raportin vlerësues të ekspertit H.M të datës 11.12.2023 dhe ekspertizen e elektros së kryer nga eksperti B.F datë 26.02.2024 si dhe ka vështruar fotodokumentacionin në shkresat e lëndës.

Nga provat e administruara për gjykatën nuk ishte kontestuese gjendja faktike se në natën kritike me datën 13.01.2017, në deponë e paditësit, ka shpërthyer zjarri dhe atë nga kablllo PP-Y 5x2,5 mm² (Cu), brenda deposë së paditësit, për shkak të vjetësisë së tij apo për shkak të mos dimensionimit adekuat të ngarkeses, lidhjes së shkurtër dhe mos instalimit adekuat të këtij kablli sipas normave teknike të instalimeve elektrike.

Nga dëftesa pagesa e datës 11.04.2017 vërtetohet se konsumator i energjisë elektrike në njuhësorin DMI 28696 ishte paditësi N.M.

Në raportin e vecant të lëshuar nga Stacioni Policor në Vushtrri, i datës 13.01.2017 përshkruhet rasti dhe theksohet se pala ankuese N.M, me datën 13.01.2017 ka paraqitë rastin e djegies së një depoje, të mbushur me patate dhe mjete bujqësore ku kishte shpërthyer një zjarr dhe si pasojë e këtij zjarri iu ishte djeg dhe dëmtuar patate 70 tonë, një trak për ngarkimin e patatave me vlerë 25,000 euro. Me datën 25.01.2017 djali i paditësit A.M, ka deklaruar se në këtë depo që ishte kall kishte pas edhe mjete tjera të punës : dy hidranta për ujë, dy shtojca njëra fi-100, dhe tjetra fi-90, (pronë e Ibër Lepencit, dy rryla 80 qepa sterpikes, 89, stërpikësja e metaltë 4.pompa te krahut për stërpikje Burmashin Brusalicë aparat për varitje 4.felne të automjetit qelsa për punë të makinerisë, dy krilla të para të traktorit Ferkuson, dhe vlera e tyre ishte 2732 euro.

Në raportin mbi deklarinimin e rastit në polici, datë 13.01.2017, gjithashtu përshkruhet rasti si më lart dhe patatet e paisjet e dëmtuara.

Nga vërtetimi i lëshuar nga NPZSh në Vushtrri i datës 16.01.2017 vërtetohet se me datën 13.01.2017 (e premte) në ora 16:45, nga 112 është lajmëruar për një zjarr në rrugën e P... S..., ku po digjej një deponi e patatave pronë private e N.M nga Vushtrria, ku si ekip kemi intervenuar menjëherë, dhe është bërë lokalizimi dhe shuarja e zjarrit, në tërësi. Aty shihej se ishte djegur deponi e patatave me dimensione 20x12.5 m², komplet kulmi, patate në mas ëtë konsiderueshme, mjete të ndryshme të bujqësisë si : traka e patatates, 4 copë pompa krahu për

sterpikje (alumini), etj, dërrasa të ndryshme, mrezha të ndryshme, dy palë dyer metali (të hekurta) të deposë.

Nga kërkesa e paditësit drejtuar të paditues datë 03.03.2017 vërtetohet se paditësi ka kërkuar kompensimin e dëmit nga e paditura.

Nga ekspertiza mbi shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm e ekspertit A.N e dates 01.02.2017, i njëjti ka ardh në përfundim se deri tek fatkeqësia është ardh – shkaktuar nga lidhja e shkurtë në kabllin furnizues të deposë PP-Y 5x2,5 mm² (Cu), për shkak të dëmtimit të pjeses izoluese të këtij kablli dhe nga lidhje e shkurtë në këtë kabëll është shkaktuar shkëndija e parë e zjarrit nga e cila pastaj është përhapë në gjithë brendinë e deposë dhe pjesen drurore të kulmit ku është djegur tërësisht.

Nga fotodokumentacioni në shkresat e lëndës shihet depoja e djegur.

Nga raporti i komisionit të të paditues datë 13.03.2017 i njëjti ka konstatuar se shkaktar i dëmit nuk është e paditura dhe se e paditura nuk mban kurrfarë përgjegjësie për këtë rast, K... është përgjegjës për furnizim cilësor deri tek pika matëse e konsumatorit.

Nga ekspertiza e ndërtimtarisë e kryer nga D.Sh në procedurën e sigurimit të provave, i njëjti konstaton se dëmi i paditësit në objekt-depo është prej 2817 euro.

Nga raporti vlerësues i kryer nga eksperti H.M e datës 11.12.2023 i njëjti konstaton se dëmi që i është shkaktuar paditësit në depo është prej 11,980 euro.

Nga ekspertiza e elektros e kryer nga B.F e datës 26.02.2024 vërtetohet se në ditën kritike me datën 13.01.2017, në deponë e paditësit, ka shpërthyer zjarri dhe atë nga kabllo PP-Y 5x2,5 mm² (Cu), brenda deposë së paditësit, për shkak të vjetësisë së tij apo për shkak të mos dimensionimit adekuat të ngarkesës, lidhjes së shkurtër dhe mos instalimit adekuat të këtij kablli sipas normave teknike të instalimeve elektrike.

Gjykata pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, erdhi në përfundim se me asnjë provë, nuk është vërtetuar se me fajin e të paditurës K... i është shkaktuar dëmi material paditësit, sipas sipas të dy ekspertizave të elektros dhe atë të ekspertit A.N e cila është kryer në procedurë parapenale dhe ekspertiza e ekspertit B.F e kryer në këtë çështje kontestimore, fajësia për dëmin e shkaktuar bie mbi paditësin për shkak së sipas ekspertizes së parë, deri tek fatkeqësia është ardh – shkaktuar nga lidhja e shkurtë në kabllin furnizues të deposë PP-Y 5x2,5 mm² (Cu), për shkak të dëmtimit të pjesës izoluese të këtij kablli dhe nga lidhje e shkurtë në këtë kabëll është shkaktuar shkëndija e parë e zjarrit nga e cila pastaj është përhapë në gjithë brendinë e deposë dhe pjesen drurore të kulmit ku është djegur tërësisht, e gjithashtu edhe ekspertiza e dytë e elektros vjen në përfundim se zjarri ka shpërthyer tek kablloja PP-Y 5x2,5 mm² (Cu), brenda deposë së paditësit, për shkak të vjetësisë së tij apo për shkak të mos dimensionimit adekuat të ngarkesës, lidhjes së shkurtër dhe mos instalimit adekuat të këtij kablli sipas normave teknike të instalimeve elektrike.

Pra nga të dy ekspertizat e elektros, nuk del se me lëshimet apo fajin e të paditues, paditësit i është shkaktuar dëmi, kompensimin e të cilit e kërkon në këtë çështje kontestimore.

Gjykata duke u bazuar në nenin 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, e në të cilën dispozitë ligjore është paraparë se: Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit, ndërsa neni 158, ka paraparë : Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë

sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet, e që ne rastin konkret u vërtetua se zjarri ka buruar brenda përgjegjësisë së konsumatorit sepse deri tek fatkeqësia është ardh – shkaktuar nga lidhja e shkurtë në kabllin furnizues të deposë PP-Y 5x2,5 mm² (Cu), për shkak të dëmtimit të pjesës izoluese të këtij kablli, pra paditësi nuk e ka mënjeluar rrezikun që paraqet kabloja me pjesën izoluese të dëmtuar, e si rrjedhojë e saj është shkaktuar shkëndija e parë e zjarrit nga e cila pastaj është përhapë në gjithë brendinë e deposë dhe pjesen drurore të kulmit ku është djegur tërësisht, pasi që kabloja në fjalë del të jetë e vjetruar, ose paditësi nuk e ka bërë dimensionimin adekuat të ngarkesës, pra e ka stërngarkuar ngarkesën e hargjimit elektrik apo nuk e ka instaluar në mënyrë adekuate këtë kabëll sipas normave teknike të instalimeve elektrike, por sido që të jetë, në të gjitha këto situata, e paditura nuk është përgjegjëse sepse instalimin elektrik në zonen ku ka shpërthyer zjarri, e ka bërë paditësi dhe e paditura për mënyren e instalimit të energjisë elektrike nga paditësi, brenda zones së tij të përgjegjësisë, nuk bart përgjegjësi.

Gjykata nuk është lëshuar në shqyrtimin e provave materiale sa i përket vërtetimit të lartësisë së dëmit, për shkak të pamundësisë së vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadsisë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par 1 të LPK-së ku përcaktohet se: Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqfituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore, ashtu që duke marrë parasysh se paditësi ka humb procesin gjyqësor, u obligua si në pikën II të këtij aktgjykimi, pasi që e paditura ka kërkuar shpenzimet për kryerje të ekspertizës së elektros nga eksperti B.F në lartësi prej 170 euro.

Gjykata aktgjykimin e bazoi në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.197/17, datë: 12.03.2024

Gjyqtari
Izet Gërguri

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesa, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, në kopje te mjaftueshme.